

Tiranë, më 7 Tetor 2021

KËRKESË PËR OFERTË
SUBJEKT TREGTAR PËR ORGANIZMIN E EVENTIT KONFERENCË RAJONALE
“Rimendimi i Tolerancës Fetare midis Partnerëve të Ballkanit Perëndimor”

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në zbatim të projektit “Drejt një dialogu më të madh ndërkulturor, ndërbesimtar dhe ndërfetar në Ballkanin Perëndimor”, mundësuar dhe mbështetur financiarisht nga organizata jofitimprurëse donatore DRA, Civic Solidarity Platform dhe Zyra Federale e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, shpall kërkesën për ofertë për një subjekt tregtar i cili ofron me qera, për një ditë, një salle konferencash bashkë me pajisjet mbështetëse (2 mikrofonë statikë dhe 4 të lëvizshëm/sistem audio/monitor vizual për shfaqjen e prezantimeve në powerpoint, internet Wifi, pajisjet për përkthim simultan, sistem për realizimin e eventit në format online hibrid¹ etj.) për organizimin e një konference rajonale në Tiranë më datë 21 Tetor 2021, në harkun kohor 10:15-15:10 .

Organizimi i eventit duhet të bëhet i mundur në përputhje me masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19 nga ana e autoriteteve shtetërore.

Gjithashtu, subjekti tregtar duhet të ofrojë koktejl & finger food në formën banket i hapur për rreth 50 pjesëmarrës.

Oferta financiare duhet të përfshijë:

- Ofertën financiare për qeranë e sallës (duke identifikuar dhe kostot respektive për mjetet facilituese të sipërpërmendura të përfshira në këtë vlerë, si dhe duke përcaktuar kapacitetin e sallës)
- Ofertën financiare për pajisjet e përkthimit simultan
- Ofertën financiare për menu coctail & finger food, e cila nuk duhet të kalojë shumën totale prej 450 €.

¹ Ky sistem duhet të përfshijë realizimin e eventit fizikisht dhe nëpërmjet platformës zoom.

KShH fton të gjitha subjektet e interesuara që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al ose postare, deri në datën 11.10.2021, dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Ofertën financiare në Euro (me TVSH të përfshirë) *²**
- 2. Foto të sallës në të cilën do të realizohet eventi**
- 3. Listë e pajisjeve facilituese të cilat përfshihen në çmimin e qerasë**
- 4. Çertifikatën e regjistrimit (nqs ofertuesi është kompani/subjekt tregtar)**
- 5. Oferta duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur**

² *Subjektet që nuk i nënshtrohen TVSH ta deklarojnë këtë status.